

# **Prezantim i informacionit ekzistues mbi dhunen në familje në Shqipëri**

*Mbështetur nga:*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMITETI GRUAJA DHE FAMILJA**

dhe

**UNICEF**

**Tetor 2000  
Tiranë, Shqipëri**

## Me pak fjalë

*Situata e grave në Shqipëri, veçanërisht përsa i përket fenomenit të dhunës në familje, është përkeqësuar gjatë dhjetë viteve të fundit, dhe kjo në një kohë kur mungojnë të dhënat e besueshme zyrtare që vërtetojnë fenomenin. Dhuna në familje në Shqipëri mbetet prapa dyerve të mbyllura dhe mbështet nga qendrimet patriarkale dhe tradicionale që burojnë nga Kanuni (Kodi i ligjeve zakonore që përdorej në Shqipërinë Veriore).*

### **Ky raport, pikë së pari,**

*grumbullon studimet ekzistuese që merren me analizën e përmasave, frekuencën, dhe natyrën e problemit, identifikimin e grupeve të rrezikuara nga dhuna në familje, shkaqet dhe pasojat e saj, të dhëna statistikore, ligje, politika, programe, studime dhe shërbime. Dhuna ndodh pavarësisht nga besimi fetar. Gratë me arsim të lartë janë më të fuqizuara dhe të përgatitura për të nxitur komunikimin me bashkëshortët e tyre, e për këtë arsye, janë më pak të rrezikuara të vuajnë nga dhuna në familje. Gratë që janë të papuna dhe që jetojnë në zonat rurale janë më të rrezikuara nga abuzimi fizik. Gratë në moshë të re, nga 20 deri në 30 vjec, janë më të rrezikuara nga abuzimi fizik dhe ai seksual dhe në të njëjtën kohë të prirura për të kërkuar ndihmë. Përsa i përket dhunës në familje, nuk ka një shpjegim të thjeshtë. Alkoolozmi, xhelozia, papunësia, varfëria janë nga shkaqet kryesore. Niveli i lartë i varësisë ekonomike të grave nga burrat, mungesa e zbatimit të ligjit dhe fakti që legjislacionit shqiptar i mungojnë dispozita të veçanta për të mbrojtur gratë brenda dhe jashtë shtetësisë, të gjitha këto, kontribuojnë në përforcimin e ciklit të dhunës. Kodi Civil i Shqipërisë nuk ka të përfshira dispozita që të mundësojnë që një njeri që beson se ndodhet në rrezik, të kërkojë me vendim gjykatë të mbrohet për të parandaluar dhunën. Vetëm 5% e rasteve të dhunës në familje çohen në gjykatë. Reagimet e grave ndaj dhunës varen nga niveli i tyre i ndërgjegjësimit, arsimimi, aftësia për të luftuar për të mbrojtur vetveten, mbështetja që kanë nga prindërit e tyre, situata ekonomike, mbështetja nga fëmijët e tyre, dhe informacioni që ato kanë për shërbimet sociale ekzistuese. Fëmijët që preken nga dhuna izoloohen në një moshë të re dhe janë të rrezikuar të marginalizohen edhe më tej në shoqëri.*

### **Se dyti,**

*ky raport përcakton pozicionin e aktorëve të ndryshëm. Për arsye të ndryshme, siç mund të jenë mungesa e besimit tek autoritetet, turpi dhe frika e hakmarrjes nga abuzuesi, gratë viktime të dhunës nuk e raportojnë atë në polici. OJQ-të nuk mundën t'i përgjigjen të gjitha nevojave të viktimave të dhunës në familje. Universiteti i Tiranës publikon çdo vit një numër të kufizuar botimesh mbi problemet sociale. Dhuna në familje është një problem social që në ditët tona tërheq vemendjen e gazetarëve, por shumë artikuj i viktimizojnë gratë e abuzuara duke theksuar edhe më tej paragjykimet dhe stereotipet ekzistuese.*

### **Së treti,**

*ky raport bën një paraqitje grafike të rrjeteve dhe iniciativave ekzistuese që luftojnë kundër dhunës në familje në Shqipëri. Ka një numër gjithnjë e në rritje të organizatave të grave që janë përfshirë në propagandimin e të drejtave të grave, në organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik për këtë problem, dhe në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për gratë, vajzat dhe fëmijët e abuzuar. Këto shërbime përfshijnë: këshillim psikologjik, këshillim ligjor, strehim dhe punësim.*

#### **Së katërti,**

*raporti bën rekomandime se si aktorë të ndryshëm mund të përfshihen për ta thelluar më tej këtë studim, veçanërisht përsa i përket hartimit dhe zbatimit të aktiviteteve të ndryshme. Ai rekomandon nevojën për të organizuar trajnime të punonjësve të shëndetësisë, forcave të policisë, gjykatësve dhe gazetarëve, si dhe kurse trajnime që lehtësojnë punësimin e grave. Rekomandohet nevoja e organizimit të një studimi mbarë kombëtar për problemet e dhunës. Sensibilizimi i nxënësve të shkollave të tjetër dhe të mesme rekomandohet gjithashtu. Dhe së fundi , rekomandohet ngritja e projekteve në komunitet, si grupet mbështetëse për burrat që duan të dalin nga situata e rëndë, ngritja e strehëzave dhe e linjave të tjera të këshillimit,etj.*

# Përmbajtja

*Me pak fjale*

*Lista e shkurtimeve*

*Hyrje*

***Pjesa I- Informacioni ekzistues mbi dhunën në familje***

**A-Përmasat, frekuenca dhe natyra e problemit**

**B-Identifikimi i grupeve voluntiere të dhunës në familje sipas faktorëve të ndryshëm**

*Feja*

*Edukimi*

*Gjeografia*

*Profesioni*

*Mosha*

**C-Shkaqet**

**D-Kuadri Ligjor**

**E-Pasojat: Kush vuan nga dhuna në familje?**

*Efekti mbi gruan*

*Efekti mbi fëmijën*

***Pjesa II- Pozicioni i Aktorëve të ndryshëm***

**A-Punonjësi Civil**

**B-Anëtarët e Parlamentit**

**C-Antarë të Komunitetit Akademik**

**D-Organizatrat Ndërkombëtare**

***Pjesa III- Paraqitja grafike e rrjeteve dhe iniciativave egzistuese të luftës kundër dhunës në familje në Shqipëri***

**Skema 1** Këshilli Kombëtar i gruas Shqipëare

**Skema 2** Koalicioni Shqiptar kundër dhunës

gjinore dhe trafikimit

**Skema 3** Rrjeti kundër dhunës gjinore dhe trafikimit

***Pjesa IV- Rekomandime***

**Trajnime**

**Qeveria**

**Policia**

**Studime**

**Fushata Sensibilizimi**

**Projekte për komunitetin**

***Konkluzione***

***Bibliografia***

## Lista e shkurtimeve

ICMC: Komiteti Ndërkombëtar katolik i Migrimit

ICITAP: Programi Ndërkombëtar për Asistencën në Trajnimin për Investigimin Kriminal (Departamenti i Shtetit për Drejtësi)

IOM: Organizata Ndërkombëtare për Migrim

MAPE: Elementi Shumëkombësh Këshillimor për Policinë

NCËF: Komiteti Kombëtar për Gruan dhe Familjen

NPA: Ndhima e Popullit Norvegjes

NOVIB: Organizata Hollandeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim ndërkombëtar

ORT: Organizata për Rihabilitim dhe Trajnim

OSCE: Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë

PHARE: Ndhima Polake dhe Hungareze për Rikonstruksionin e Ekonomisë

SNV: Organizata Hollandeze për Zhvillim

UNDP: Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

UNICEF: Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara

UNOHCHR: Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionit të lartë për të Drejtat e Njeriut

UNOPS: Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projekt

USIS: Shërbimi i Informacionit i Shteteve të Bashkuara

## Hyrje

Gjendja e grave shqiptare, veçanërisht përsa i përket dhunës në familje, është përkeqësuar gjatë dhjetë viteve të fundit. Në periudhën e komunizmit problemet e dhunës në familje konsideroheshin tabu. Askush nuk guxonte t'i bënte ato publike. Ato konsideroheshin si jo egzistente, ose në rastin më të mirë problemi trajtohej nga organizata e Partisë. Edhe sot, Shqipëria ende nuk ka një kuadër ligjor që t'i mbrojë gratë nga dhuna në familje, por nuk ka as bashkëpunim midis policisë, juristëve, punonjësve socialë dhe punonjësve të shëndetësisë për të mbështetur gratë e dhunuara. Dhuna ndaj grave shqiptare është përkeqësuar edhe nga prevalenca e lartë e trafikimit dhe prostitucionit në vend dhe në vendet e Ballkanit.

Në këtë punim, ne i referohemi dhunës në familje si dhunë që ushtrohet nga partnerët intim dhe antarët e tjerë të familjes dhe manifestohet përmes:

*Abuzimit fizik siç është goditja me shuplakë, rrahja, përdredhja e krahut, goditja me thikë, mbytja, djegja, goditja me shqelma, kërcënimi me armë dhe vrasja. Ky lloj abuzimi përfshin gjithashtu praktika tradicionale të dëmshme për gruan siç është trashëgimi i bashkëshortes (praktika e trashëgimit të bashkëshortes dhe pasurisë së saj tek vëllai i burrit të vdekur).*

*Abuzimi seksual siç është krijimi i marrëdhënieve seksuale nëpërmjet kërcënimit, frikësimit ose forcës fizike, të detyruarit të seksit ose të detyruarit të seksit me të tjerët.*

*Abuzimi psikologjik që përfshin sjellje që kanë për qëllim të frikësojnë ose persekutojnë dhe që merr formën e kërcënimeve për abandonim dhe abuzim, mbyllje në shtëpi, survejim, kërcënim për të marrë fëmijët, thyerje të objekteve, izolim, agresion verbal dhe fyerje të vazhdueshme.*

*Abuzimi ekonomik përfshin akte siç mund të jenë mohimi parave, refuzimi për të kontribuar financiarisht, mohimi i ushqimit dhe nevojave bazë, mbajtja nën kontroll i kujdesit shëndetësor dhe punësimit, etj<sup>1</sup>.*

Qëllimet e këtij raporti janë si vijon : së pari, të mblidhen studimet egzistuese, të analizohen përmasat, frekuenca dhe natyra e problemit, të identifikohen grupet vulnerabël të dhunës në familje, shkaqet dhe pasojat e saj, të dhënat, ligjet, politikat, programet, studimet dhe shërbimet; së dyti, të identifikohet pozicioni i aktorëve kyç; së treti, të bëhet paraqitja grafike e rrjeteve dhe iniciativave egzistuese që luftojnë dhunën në familje në Shqipëri; dhe së katërti, të bëhen rekomandime se si të përfshihen aktorë të ndryshëm për ta vazhduar këtë studim me hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të ardhshëm. Ne shpresojmë se ky studim do të ketë një impakt në çështjen e dhunës në familje dhe do të rrisë interesimin e publikut.

## Pjesa I

### Informacioni ekzistues mbi dhunën në familje

#### A- Përmasat, frekuencat dhe natyra e problemit

Dhuna kundër grave në Shqipëri duhet të analizohet në kontekstin e kulturës dhe traditave shqiptare. Studimi i dhunës në familje është i komplikuar, sepse ajo është një fenomen që ndodh prapa dyerve. Njerëzit nuk preferojnë të flasin mbi këtë çështje sepse ata e konsiderojnë atë çështje private dhe burim turpi. Gjithashtu, ky problem mbështetet nga mentaliteti tradicional dhe patriarkal që është thellësisht i rrënjësuar në kulturën shqiptare<sup>2</sup>. Rrënjët e keqtrajtimit të vazhdueshëm të grave shqiptare nga burrat janë të vjetra dhe të thella dhe janë të lidhura me mungesën e respektit. Duket kontradiktor fakti që Kanuni (Kodi i ligjeve zakonore të përdorura në pjesën veriore të Shqipërisë) përfshin akte që e deklarojnë gruan si të paprekshme<sup>3</sup>. Sala dhe Miria përpiqen ta shpjegojnë këtë duke shkruar:

*Mbështetur në aktet dhe kundra aktet mbi gruan ngrihet pyetja: Pse gruaja konsiderohej e paprekshme? Sepse ajo nevojitej për të lindur fëmijë, për t'u kujdesur për fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes dhe për punët e shtëpisë. Nga kjo pikpamje, ishte e vështirë të pranohej barazia e gruas me burrin. Sipas Kanunit, gruaja është një objekt që merr frymë, ajo është një pasuri dhe si e tillë nuk mund të respektohet nga anëtarët meshkuj të familjes<sup>4</sup>.*

Kanuni përmend faktin se burrat kanë të drejtë të rrahin dhe të fyejnë publikisht bashkëshortet e tyre nëse bashkëshortet nuk u binden atyre. Nëse gruaja “nuk silltet mirë ndaj të shoqit<sup>5</sup>” burri ka të drejtë “t’i presë një shirit nga brezi i saj ose t’i presë një tufë nga flokët e saj<sup>6</sup>” dhe ta lërë atë. Burri mundet t’i presë flokët gruas së tij, ta çveshë atë lakuriq, ta përzërë atë nga shtëpia në sy të të afërmeve dhe më pas ta ngasë atë me shkop mes përmes gjithë fshatit. Më tej në Kanun thuhet:

*Nëse burri e rreh gruan e tij, ai nuk quhet fajtor dhe prindërit e saj nuk mund të bëjnë asnjë ankesë për burrin që e ka rrahur. Nëse burri e rreh gruan deri në gjakosje, dhe ajo ankohet tek prindërit, burri duhet të japë shpjegime<sup>7</sup>.*

Në Kanun sqarohet se, burri mund ta vrasë gruan e tij në dy raste, për kurvëri dhe tradhëti të mikpritjes<sup>8</sup>. Për këto dy akte të pandershmërisë, burri e vret gruan e tij, nuk kërkon mbrojtje dhe nuk hyn në gjakmarrje, pasi prindërit e gruas së tij të vararë e kanë marrë çmimin e gjakut të saj kur i kanë dhënë dhëndërrit një fishek ditën e dasmës, për të garantuar sjelljen e saj.

Pesëdhjetë vjet të sundimit komunist nuk e fshinë qëndrimin patriarkal të lidhur me Kanunin. Shumë gra akoma e shikojnë pozitën e tyre sociale nën ndikimin e këtyre ligjeve zakonore.

*Shpesh thuhet se Kanuni është burimi kryesor për pozitën e diskriminuar të grave në shoqërinë shqiptare, argument ky shumë i diskutueshëm e ndofta spekulativ. Çështja e historisë së pozitës së nënshtruar të grave në shoqërinë shqiptare në këtë shekull ka nevojë për një analizë më të plotë, duke marrë në konsideratë shumë faktorë, si nivelin shumë të ulët të zhvillimit ekonomik e shoqëror, nivelet e larta të varfërisë, mungesën e stabilitetit politik, faktin që çështja e identitetit dhe e integritetit territorial shqiptar mbizotëruan jetën e vendit dhe lëvizjet politike brënda tij, mungesën e një kulture politike demokratike, nivelin e ulët arsimor, mungesën e lëvizjeve të gjëra emancipuese shoqërore etj. Kanuni është vetëm një nga këta faktorë dhe vepronte vetëm në një pjesë të vendit. P.sh. në jug nuk vepronte Kanuni, por kishte përsëri fejesa në djep<sup>9</sup>.*

Një analizë e tillë mungon në studimet ekzistuese, dhe në ndjehemi të detyruar të prezantojmë nevojën për një analizë të plotë të fenomenit dhe të situatës së gruas në atë kohë.

Autorë të tjerë janë përpjekur, gjithashtu, të analizojnë natyrën e këtij fenomeni në Shqipëri. S. Gjipali dhe L. Ruci në studimin e tyre *Gruaja shqiptare: Hezitime dhe Perspektiva*, përpiqen të shpjegojnë influencën e vështirësive ekonomike në pozitën e varur të gruas shqiptare:

*Gjithashtu duhet të kuptojmë situatën e grave shqiptare gjatë gjysmës së fundit të shekullit tonë dhe progresin që ato kanë bërë ... Shqipëria ishte dhe vazhdon të jetë një vend me një popullsi fshatare mbizotëruese (64 % e popullsisë aktualisht jeton në fshat) ... Prapambetja intelektuale dhe materiale krijoi kushte për nënvlerësimin dhe keqtrajtimin e gruas (mjafton të themi se rrahja e gruas konsiderohej gjë normale)<sup>10</sup>.*

Për një kohë të gjatë studimet dhe të dhënat mbi dhunën në familje kanë munguar plotësisht. Në vitin 1996, shoqata e grave "Refleksione", organizoi të parin studim kombëtar mbi dhunën në familje, financuar nga Programi PHARE Democracy. Në këtë studim S. Miria jep të dhënat e para që tregojnë se 64 % (nga 849 gra) e grave të intervistuar pranojnë të kanë përjetuar dhunë fizike, emocionale dhe seksuale.

*64% e grave të intervistuar pranojnë se ato janë ndjerë të dhunuara fizikisht apo shpirtërisht nga partneri i tyre ose nga anëtarë të tjerë të familjes... 35 % e të intervistuarve kanë qënë dëshmitare të dhunës serioze fizike e psikologjike në familjen e tyre të origjinës<sup>11</sup>.*

Permasat e këtij problemi mund të kuptohen duke marrë në konsideratë të dhëna të tjera nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza. Në më pak se 5 vjet të ekzistencës së saj, Linja ka marrë më shumë se 5000 telefonata. Në periudhën 1996-2000, më shumë se 400

gra janë këshilluar ballëpërballë. Klientet kanë qënë nga të gjitha rrethet e vendit. Një fakt tjetër për frekuencën e fenomenit është numri i klienteve të trajtuara në Strehëzën për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara në një periudhë kohore më të shkurtër se dy vjet. Kjo Strehëz, e ngritur në Tiranë, është e vetmja e këtij lloji në Shqipëri dhe mbështetet nga donatorë të huaj. Rreth 32 gra dhe 40 fëmije janë trajtuar në këtë Strehëz në 18 muaj aktivitet. Kërkesat për strehim janë shumë më të mëdha se kapacitati i Strehëzës. Strehëza pothuaj çdo muaj ka një ose dy kliente mbi kapacitetin e saj. Numri i rasteve të kthyer (të papranuara) është pothuaj i barabartë me sasinë e klienteve të trajtuara në Strehëz. Këto të dhëna na ndihmojnë të kuptojmë se dhuna ndaj gruas nuk ndodh rastësisht, por ajo është një fenomen i përhapur në Shqipëri. Fenomeni përfshin të gjitha moshat dhe besimet fetare.

## **B- Identifikimi i grupeve vulnerabël të dhunës në familje në varësi të faktorëve të ndryshëm**

### *Feja*

Sipas studimit të bërë nga Refleksione vitin 1996 rezulton se: nga 27 % gra të besimit mysliman që i janë përgjigjur pyetësorit, vetëm 9 % e tyre kanë pranuar se kanë qënë dëshmitare të dhunës së përsëritur në familjen e tyre. E njëjta përqindje merret edhe nga 31 % të besimit orthodoks dhe 27 % të besimit katolik. Dhuna nuk ka bazë fetare<sup>12</sup>.

### *Edukimi*

Studimi i rasteve të trajtuara në Strehëz tregon se dhuna ndodh pavarësisht nga niveli i edukimit të grave. Nga 32 raste të Strehëzës, 3 gra (ose 10%) kanë qënë me arsim të lartë, 10 gra (ose 31%) me arsim të mesëm, 14 gra (ose 43%) me arsim tetëvjeçar dhe 5 gra (ose 15%) me arsim fillor. Eksperienca më e fundit e Strehëzës nuk ndryshon shumë nga situata e prezantuar nga S.Miria në studimin e saj të vitit 1996. Autorja e mësipërme tregon se nga gratë e intervistuar, që kanë pranuar se kanë përjetuar dhunë, 7% janë me arsim fillor, rreth 10% me arsim tetëvjeçar, 6% me arsim të mesëm dhe 3% me arsim të lartë<sup>14</sup>. Kategoritë e grave më të rrezikuara janë ato me nivel të ulët edukimi dhe siç tregojnë të dhënat niveli i dhunës bie kur gratë kanë nivel më të lartë edukimi. Gratë me arsim të lartë janë psikologjikisht të abuzuara. Është evidente nevoja e një studimi të thelluar në këtë fushë. Përshtypja e autoreve të këtij punimi është se gratë me arsim të lartë janë më të fuqizuara dhe janë më të përgatitura për të nxitur komunikimin me bashkëshortët e tyre, gjë që mbetet të provohet.

## *Gjeografia*

Pjesa më e madhe e punës kërkimore të realizuar shpalos një element të rëndësishëm të saj, shpërndarjen gjeografike të dhunës në familje . P.sh. anketimi i B.Kaçit i vitit 1996, tregon se 46% e grave që jetojnë në zonat rurale pranojnë se janë abuzuar fizikisht, krahasuar kjo me 36% të grave që jetojnë në qytet<sup>15</sup>. 28% e grave të intervistuar, që jetojnë në zonat rurale, pranonin të jenë abuzuar seksualisht krahasuar me 16% të grave në zonat urbane. Fakti që gratë fshatare pranojnë se jetojnë me një bashkëshort abuziv tregon se ato po ndërgjegjësohen për jetën e tyre, por njëkohësisht nënvizon jetën e vështirë të grave që jetojnë në zonat rurale. Format ekstreme të dhunës kundër gruas nuk janë karakteristika të zonave të caktuara. Mes grave që pranojnë të kenë përjetuar dhunë ekstreme, 5% jetojnë në fshat dhe 5% në qytet<sup>16</sup>.

## *Profesioni*

Të dhëna të tjera tregojnë lidhjen e dhunës ndaj gruas dhe statusit profesional të saj. Si S.Miria ashtu edhe B.Kaçi gjejnë se midis grave të intervistuar që pranojnë se jetojnë me një partner abuziv, rreth 50% e tyre janë shtëpiake dhe të papuna.

## *Mosha*

Një variabël tjetër i rëndësishëm është ai i marrëdhënies midis nivelit të abuzimit dhe moshës së grave. Eksperianca e rasteve të trajtuara në Strehëz tregon se dhuna është një fenomen që përfshin të gjitha moshat. Megjithatë, disa diferenca mes grupmoshave të ndryshme mund të vihen re. 12% e rasteve të trajtuara në Strehëz janë nën moshën 20 vjeç, 50% nga 20-30vjeç, dhe 33% mbi 30 vjeç<sup>17</sup>. Të dhënat e grumbulluara nga Qendra e Këshillimit konfirmojnë se gratë në moshë të re janë më të ekspozuara ndaj dhunës fizike dhe seksuale dhe të prira për të kërkuar ndihmë. Në fakt 76% e numrit të pergjithshëm të telefonatave të marra gjatë 5 vjetëve të ekzistencës, kanë qënë nga vajza dhe gra nën 30 vjeç. Eksperianca e Qendrës së Këshillimit dhe Strehëzës tregon se kjo grupmoshë është më e rëndësishme ndaj problemit të dhunës dhe pasojave të saj. Fakti që gratë mbi 30 vjeç janë më pak të prirura për ta raportuar dhunën nuk do të thotë se ato përjetojnë më pak dhunë. Ky fakt tregon se ato ose mësohen ta “tolerojnë” ose ta “pranojnë” jetesën në një marrëdhënie abuzive. Studimi të tjera në të ardhmë duhet të verifikojnë dhe provojnë relacionin midis moshës dhe nivelit të abuzimit që përjetohej nga gratë.

## **C- Shkaqet**

Për shkaqet e dhunës në familje nuk ekziston një shpjegim i thjeshtë. Studimet

tregojnë se dhuna në familje është e rrënjosur në rolet e varura që gratë kanë patur tradicionalisht në jetën private dhe ato publike. Në Deklaratën e Kombeve të Bashkuar për Eliminimin e dhunës kundër gruas, dhuna ndaj gruas përcaktohet si “një manifestim i marrëdhënieve të pushtetit të pabarabartë që historikisht ka ekzistuar midis burrit dhe gruas” dhe e dënon dhunën si një nga “mekanizmat kryesorë socialë që i detyron gratë të kenë një pozitë të varur nga burrat<sup>18</sup>”. Studjues të ndryshëm japin spjegime të ndryshme për shkaqet e dhunës në familje në Shqipëri. Megjithatë, të gjithë janë dakord se në Shqipëri ekziston një mentalitet mbizotërues se burrat kanë të drejtë të kontrollojnë me çdo mjet sjelljet e grave. Avokatet e Minnesotës për të Drejtat e Njeriut, në studimin e tyre (1996) mbi dhunën në familje në Shqipëri, nënvizojnë se “shumica e grave janë të mendimit se mentaliteti i burrave për gratë si pasuri e tyre është burimi i dhunës”. Raporti spjeron se dhuna fizike dhe psikologjike ndaj grave dhe shpeshherë edhe ndaj fëmijve buron nga “dëshira e burrave për të kontrolluar me çdo kusht jetën e anëtarëve të tjerë të familjes<sup>19</sup>”.

Mbështetur në studime të ndryshme, shkaqet e dhunës mund t’i ndajmë në dy kategori kryesore. Së pari, shkaqe që janë të lidhura me karakteristikat individuale të personit që e ushtron dhunën apo që e përjeton atë. Së dyti, shkaqe që janë të lidhura me atmosferën e përgjithëshme në shoqëri, siç janë sjelljet dhe mentalitetet e përpunuara nga shoqëria. Për kategorinë e parë të shkaqeve, sipas S.Mirisë në studimin e saj “Dhuna kundër gruas dhe tabutë psikosociale që e favorizojnë atë”, rezultatet e pyetësorit janë si më poshtë :

*Alkoholizmi në 80% të rasteve,*  
*Xhelozia në 76% të rasteve,*  
*Papunësia në 52% të rasteve,*  
*Varfëria në 50% të rasteve,*  
*Stresi në 43% të rasteve,*  
*Impotenca seksuale në 22% të rasteve,*  
*Komplekse të ndryshme inferioriteti brënda*  
*16% të rasteve,*  
*Konkurenca intelektuale, profesionale dhe arsimore*  
*çiftit në 19%,*  
*Paftësia profesionale në 9% të rasteve,*  
*Shtatëzania e padëshiruar në 10% të rasteve<sup>20</sup>.*

Studjues të tjerë i kanë shtuar karakteristika të tjera kësaj liste. E. Haxhiymeri dhe E. Kulluri në studimin e tyre për rastet e klienteve të trajtuar në Strehëz, nënvizojnë

eksperiencat abuzive që të dy partnerët sjellin në familjen e tyre të re. Fakti që ata kanë përjetuar dhunë i bën ata lehtësisht abuzues në ambientin e ri. Ata nuk dinë eksperiencat më të mira dhe vazhdojnë të sillen sipas modeleve që kanë mësuar në familjet e origjinës. Autoret e mësipërme përmëdin edhe mungesën e komunikimit të përshtatshëm midis partnerëve si shkak tjetër i dhunës . Në një situatë të tillë ata mësojnë se rruga dhe mënyra më e lehtë për të kontrolluar situatën është përdorimi i dhunës, duke harruar ose duke mos marrë parasysh pasojat e saj. Autoret përmëdin edhe probleme të shëndetit mendor tek burri që mund të jetë një tjetër shkak për dhunë. Rastet e lidhura me këtë shkak nuk janë të shumta, por mbeten të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë. Të dhënat e shërbimit psikiatrik në Shqipëri mungojnë. Për kategorinë e dytë ne do të prezantojmë rezultatet e studimit të bërë nga Sala dhe Miria mbi këtë problem :

*Mendësia dhe tradita kulturore shqiptare i rezervon gruas një pozicion inferior në krahasim me meshkujt.*

*Mangësitë në legjislacionin dhe moszbatimi i ligjeve ekzistuese, nuk arrijnë t'i mbrojnë gratë brënda dhe jashtë mureve të shtëpisë.*

*Kushtet ekonomike dhe shoqërore të grave janë inferiore në krahasim me ato të burrave, sepse situata aktuale ka shkaktuar varësi më të thellë ekonomike të grave, që do të thotë më pak shanse për jetë të pavarur ekonomike dhe shoqërore.*

*Situata politike e dhjetë viteve të fundit ... ka krijuar një mjedis të disfavorshëm për gratë në Shqipëri, jo vetëm lidhur me pjesmarrjen e tyre në marrjen e vendimeve, por edhe në shumë aspekte të tjera.*

*Në disa raste, bashkësia nxit forma të caktuara të dhunës ndaj grave.*

*Për një kohë të gjatë dhuna në familje konsiderohej si problem që i përkiste vetëm çiftit që po e përjetonte atë.*

*Niveli i lartë i papunësisë, veçanërisht mes grave, emigracioni dhe migrimi brënda vendit .... kanë kushtëzuar një periudhë të përjashtimit social për gratë , proces që fillon me marginalizimin përjashtimin social, por që nuk përfundon këtu<sup>21</sup>.*

Në këtë kontekst, autoret e këtij punimi do të shtronin edhe tri shkaqe të tjera : Së pari, përfshirja e burrave në aktivitete kriminale siç janë trafiqet e ndryshme, trafikimi i mishit të bardhë, të cilat kanë rritur nivelin e stresit të përditshëm dhe i bën gratë objekt të shkarkimit të zëmërimit të burrave. Së dyti, përfshirja e burrave në lojrat e fatit si rezultat i papunësisë, mungesës së shanseve të tjera, vakumit në jetën e tyre sociale dhe shpirtërore, në fund të fundit çon në rritjen e tensionit në familje dhe shkakton dhunë. Së treti, rritja e numrit të njerëzve që kanë mendimin e të bërit të pasur shpejt, ka ndikuar në

nivelin e stresit social, që indirekt shkakton dhunë në familje.

## D- Kuadri Ligjor

Dhuna në familje ka edhe origjine institucionale. Është e vërtetë që karakteristikat individuale dhe normat sociale e “ushqejnë” dhunën, por këto nuk janë të vetmit shkaqe. Individët ose grupet që ushtrojnë dhunë favorizohen nga mungesa e kuadrit ligjor ose e moszbatimit të ligjit që i bën ata përgjegjës për sjelljet e tyre. A.Fullani, drejtoreshë e Qendrës Avokatore për Gratë, ka realizuar një studim për të *Drejtat Juridike të Grave* (1999) dhe një *Studim Krahasues të Legjislacionit Shqiptar me atë të Vendeve të Zhvilluara mbi Problemin e Dhunës ndaj Grave* (1995):

*... dhuna në familje është një temë diskutimi midis vetë grave dhe po bëhet një fushë ku shumë organizata jo qeveritare po ofrojnë shërbimet e tyre të kualifikuara dhe të dobishme. Dhe kjo në një kohë kur tema e dhunës mungon tërësisht në legjislacionin shqiptar. Sipas ligjit aktual, dhuna në familje nuk përbën një akt penal të veçantë. Ai dënohet njëjloj si një fyerje ordinere apo rrahje shkaktuar nga një i panjohur në rrugë, kur realiteti i dhunës familjare është krejt ndryshe nga ai i dhunës së përjetuar në kontekstin jashtë familjes<sup>22</sup>.*

A. Fullani sjell në vëmendjen tonë stadi të ndryshme të trajtimit të kësaj çështje. Stadi i parë ka të bëjë me momentin përpara se të ndodhë sulmi violent kundër viktimës së dhunës në familje. Teorikisht ekziston mundësia juridike për ta mbrojtur viktimën nga dhuna e parashikuar. Kjo mundësi është e parashikuar në të Drejtën Civile. Kodi Civil Shqiptar ka nevojë të pasurohet me disa amandamente specifike, sipas të cilave çdo person që mendon se ndodhet në rrezik, ka të drejtë të kërkojë një vendim të përkohshëm gjyqësor për të parandaluar ose ndaluar dhunën. Stadi i dytë ka të bëjë kur dhuna po ushtrohet ndaj viktimës së dhunës në familje. Në shumicën e rasteve të dhunës në familje viktimat ndodhet e vetme në shtëpi. Në këto kushte viktimat ka tre mundësi: të jetojë më dhunën, të përpiqet të ikë ose të qëndrojë dhe të luftojë. Në çdo rast ajo duhet të jetë e ndërgjegjshme për pasojat e sjelljes së saj. Në Shqipëri nuk ka ligj që mundëson arrestimin e dhunuesit. Nëse një grua kryen krim në përpjekje për t'u mbrojtur, ajo mund të shpallet fajtoreshë nëse nuk ka dëshmitarë të kualifikuar. Stadi i tretë ka të bëjë me momentin pasi është ushtruar dhuna. Sipas Kodit të Procedurës Penale, dhuna në familje dënohet kur viktimat ankohen në gjykatë. Çështja mbyllet kur viktimat e tërheq ankesën. Kjo do të thotë se rasti gjykohej vetëm nëse viktimat ankohen. Nga burime indirekte të informacionit ne mësuam se vetëm 5% e rasteve të dhunës në familje dërgohen në gjyq<sup>23</sup>. Bazuar në atë çka është prezantuar pak më lart lidhur me situatën në Shqipëri për dhunën në familje, mund të vijmë në konkluzionin se “...Legjislacioni Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë larg nivelit të dëshirueshëm për sa i përket dhunës në familje<sup>24</sup>”. Një grup organizatash jo qeveritare që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës në familje, kanë ngritur një grup ekspertesh, të cilët po punojnë për të përgatitur një

projektilig për problemet e dhunës në familje. Ky grup ka si objektiv të plotësojë vakumin që ekziston në legjislacionin e vendit.

## **E- Pasojat: Kush vuan nga dhuna në familje?**

### *Ndikimi mbi gratë*

Nuk ka dyshim se viktima e parë e dhunës në familje është vetë gruaja që e përjeton atë. Studimet mbi këtë problem tregojnë se gruaja reagon në forma të ndryshme ndaj dhunës në familje. Shumica prej tyre reagojnë duke fajësuar vetveten për dhunën në shtëpi. Ato gjithmonë besojnë se mund ta kishin shmangur nevrimentosjen e partnerit të tyre. Ato thonë “ ah, sikur ta kisha bërë darkën në kohë; ah, sikur të kisha folur me zë më të ulët!” Ato harrojnë ose nuk duan të besojnë se bashkëshorti violent do të gjejë një arsye tjetër për t’i dhunuar ato. Ato mbartin shumë stres mbi vete duke u përpjekur të kontrollojnë sjelljet e tyre dhe të kënaqin burrat e tyre. Një grup tjetër i grave të abuzuara ndjehen të pashpresa në situatën që ndodhen, sepse ato mendojnë se dhuna në familje është pjesë e jetës bashkëshortore. Ato kanë parë të njëjtin model me nënat e tyre dhe kanë dëgjuar se edhe gjyshet e tyre nuk kanë qënë më mirë. Kështu, ato e konsiderojnë dhunën si pjesë të jetës së tyre. Grupi i tretë i grave të dhunuara fillojnë të nënvleftësojnë vetveten dhe mendojnë se ato nuk janë të përshtatshme për partnerët e tyre, ato besojnë se nuk kanë vlera, se ato nuk vlejnë për asgjë, nuk janë të zonjat të bëjnë asgjë dhe e vendosin veten në pozicion varësie. Gra të tjera reagojnë duke u ankuar për sjelljet e burrave të tyre, fillimisht mes familjarëve dhe më pas, në rastet e dhunës së përsëritur, ato kërkojnë ndihmë tek specialistët. Të tjera gra reagojnë duke u larguar nga shtëpia dhe duke kërkuar strehim tek familjarët apo në strehëzat për gratë. Disa të tjera fillojnë të kenë probleme të shëndetit mendor dhe bëhen të varura tek anëtarë të tjerë të familjes duke e përkeqësuar situatën më tej. Në çdo rast, secila grua e abuzuar gjen mënyrën e saj të reagimit ndaj dhunës, gjë që varet nga niveli i ndërjegjësimit, i arsimimit, aftësia për të luftuar në mbrojtje të vetvetes, mbështetja që merr nga familja e origjinës, situata ekonomike, mbështetja nga fëmijët, informacioni që ajo ka mbi shërbimet sociale ekzistuese, etj.

Në përgjigje të pyetjes se si ndjehen nga eksperiencia e tyre, ato japin përgjigje të ndryshme për të shpjeguar ndjenjat e tyre. “45% janë të mbushura me zemërim, 32% ndjehen të turpëruara me situatën, 21% ju vjen keq për situatën ku ndodhen, 35% ndjehen në depresion dhe të frikësuar, 26% ndjehen fajtorë dhe 20% mendojnë të vrasin veten<sup>25</sup>.” Nuk është e vështirë të kuptohet se gra të mbushura me kaq ndjenja negative nuk janë në gjendje të funksionojnë normalisht për veten e tyre. Ato nuk janë në gjendje të marrin vendime të sakta në situatat e vështira ku ndodhen, nuk mund të mendojnë drejt, nuk janë në gjendje të drejtohen tek burimet e duhura për mbështetje, nuk mundën të

plotësojnë nevojat e tyre dhe bëhen dhunuese të fëmijëve të tyre.

### *Ndikimi mbi Fëmijët*

Fëmijët ndikohen nga dhuna po aq sa dhe nënat e tyre dhe ndonjëherë edhe më shumë. Niveli i zhvillimit të tyre psikologjik nuk i lejon të kuptojnë situatën e dhimbshme në familje. Ata ndërmarrin role të rëndësishëm në familje si kujdesi për motrat dhe vëllezërit më të vegjël; ata marrin përgjegjësinë për t'i bërë të lumtur prindërit e tyre dhe përpiqen të bëjnë gjëra që t'i bëjnë ata të ndjehen mirë. Ata janë të prirur të ndërpresin kontaktet me shokët e tyre sepse kanë frikë se mos incidentet e dhunshme ndodhin në prezencën e tyre. Ata izoloohen në një moshë të hershme dhe janë të rrezikuar të marginalizohen edhe më tej në shoqëri. Fëmijët e abuzuar përjetojnë dilemën nëse duhet ta duan dhunuesin e nënës së tyre apo duhet ta urrejnë atë. Fëmijët që rriten në ambiente të dhunshme janë të prirur t'i kthehen dhunës si metodë për zgjidhjen e problemeve kur të jenë në moshë madhore. Dhe së fundi, por që nuk është më pak e rëndësishme, këta fëmijë shumë shpejt fillojnë të shfaqin vështirësi në procesin e të mësuarit. Atyre ju mungon vëmëndja, nuk studiojnë mjaftueshëm, humbasin dëshirën për shkollim, bëhen pasivë në klasë, largohen nga orët e mësimit, kanë fjalor të kufizuar dhe vulgar, deri sa arrijnë tek momenti i braktisjes totale të shkollës. Karakteristikat e fëmijëve të abuzuar dhe pasojat e dhunës mbi ta janë përmbledhur në studimin mbi rastet e fëmijëve të trajtuar në Strehëz (Prill 2000), në temën mbi dhunën në familje nga E. Haxhiymeri (Janar 1996), dhe në studimin e shoqatës Refleksione (1997):

*Dhuna në familje është një fenomen që ndikon në jetën e secilit prej nesh. Nëse ju nuk jeni vetë dhunues ose viktimë e dhunës në familje, ka gjithnjë një mundësi që shoku juaj, një i afërm, një koleg, ose dikush tjetër pranë jush të vuajë prej saj. Kjo dhunë është rrezik për secilin prej nesh, mbi të gjitha për faktin se ai që dhunon gruan e tij, mund të bëjë të njëjtën gjë më fëmijët, fqinjët, shokët, dhe njerëzit e tjerë pranë tij<sup>26</sup>.*

Për këto arsye dhe shumë të tjera, dhuna konsiderohet një fenomen i rrezikshëm edhe për komunitetin. Frika, mungesa e stabilitetit, situata e tensionuar, izolimi social, mungesa e aktiviteteve në komunitet, mungesa e investimeve, janë vetëm disa karakteristika të komunitetit që përjeton dhunë.

## Pjesa II

### Pozicioni i Aktorëve të Ndryshëm

Për arsye të kufizimeve në kohë por edhe në hapësirë, intervistat do të jepen të përmbledhura. Për të shmangur përsëritjet, të gjitha rekomandimet e bëra nga aktorë të ndryshëm janë përmbledhur në pjesën e katërt të punimit.

#### **A- Punonjësit Civil**

*Lavdie Ruci, Drejtore e Komitetit Gruaja dhe Familja (NCWF)*

Një nga përgjegjësitë e Komitetit është të propozojë ligje të reja ose amendamente për legjislacionin ekzistues mbi të drejtat e grave dhe të fëmijëve. Komiteti sëbashku me shoqatën e grave juriste ka diskutuar mënyrat e përmirësimit të ligjit kundër dhunës ndaj gruas që do të përfshihet në Kodin e Ri të Familjes, i cili është në procesin e aprovimit nga parlamenti. Aktualisht, Komiteti Gruaja dhe Familja është i angazhuar, sëbashku me Këshillin e Europës, në përgatitjen e ligjit për “mundësitë e barabarta”. Komiteti Gruaja dhe Familja e konsideron të rëndësishëm studimin e rrugëve për të siguruar zbatimin e ligjit. Komiteti ka organizuar disa seminare në qytete të ndryshme për të diskutuar të drejtat e gruas, duke përfshirë edhe dhunën në familje, dhe legjislacionin që mbështet këto të drejta. Komiteti në bashkëpunim me Qeverinë italiane po realizon një projekt për fuqizimin e gruas.

*Engjell Hysi, Drejtor i Departamentit të  
Marrëdhënieve Publike në Ministrinë e Rendit Publik*

Një nga detyrat e Departamentit është bashkëpunimi me shoqatat joqeveritare të grave. Deri tani departamenti ka bashkëpunuar me Qendrën e Gruas dhe Komitetin Gruaja dhe Familja (veçanërisht për problemet e trafikimit). Për shumë arsye, duke përfshirë edhe mungesën e besimit tek autoritet, turpin, frikën e hakmarrjes nga abuzuesi, gratë që janë viktime të dhunës familjare nuk raportojnë në polici. Kur policia informohet për dhunë në familje, ajo ka përgjegjësi për arrestimin e dhunuesit. Rastet e dhunës në familje nuk trajtohen si raste kriminale, por si raste penale. Policët nuk janë të përgatitur për t'u marrë me rastet e dhunës në familje dhe nuk janë të përgatitur se si të ndihmojnë një grua të abuzuar dhe ku ta referojnë atë.

## **B- Anëtarë të Parlamentit**

*Merita Ndreko, Anëtare e Parlamentit, Anëtare e Komisionit  
Parlamentar për Çështjet Sociale.*

Shërbimet sociale për gratë e abuzuara janë të rëndësishme dhe të domosdoshme. Ato pak shërbime që ekzistojnë përfaqësojnë një arritje të madhe, por që nuk mund t'ju përgjigjen të gjitha nevojave. Pushteti qendror dhe ai lokal duhet t'i mbështesin këto shërbime. Decentralizimi i pushtetit lokal mbase mund të jetë një dritare për mundësi të reja. Rishikimi i Kodit të Familjes do të përfshijë edhe sanksione për dhunuesit. Kjo do të krijojë një bazë ligjore për policinë për të ndërhyrë. Është gjithashtu e domosdoshme të konsiderohet bashkëpunimi i qeverisë me shoqërinë civile. Ligji për shoqatat do të rregullojë marrëdhëniet mes tyre. Ndërsa shoqatat e grave po bëjnë një punë të lavdërueshme në fushën e shërbimeve, më shumë vëmendje kërkohet t'i kushtohet prej tyre përmirësimit të legjislacionit.

## **C- Anëtarë të komunitetit akademik**

*Ylli Pango, Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i  
Tiranës.*

Është e rëndësishme të vihet në dukje se shumë pedagogë të fakultetit janë angazhuar në projekte që synojnë mbështetjen e viktimave të dhunës në familje. Perspektiva gjinore është bërë pjesë e disa kurseve në Departamentin e Punës Sociale, si Studime Gjinore, Shëndet Mendor, Politikë Sociale, Probleme Sociale, Sjellja Njerëzore, Komunikim, etj. Problemet e dhunës në familje trajtohen më shumë në programin e Punës Sociale, por kjo nuk është e mjaftueshme, pasi studentët kanë nevojë për informacion më të thelluar në këtë fushë. Hapja e Institutit të Studimeve Gjinore, planifikuar për vitin shkollor 2000-2001, do të mundësojë përfshirjen e perspektivës gjinore në programet e lëndëve, do të mundësojë realizimin e studimeve në shkallë kombëtare dhe ngritjen e programit master për Studimet Gjinore.

*Gjergj Sinani, Pedagog i Sociologjisë në Departamentin e Filizofi-  
Sociologjise, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.*

Dhuna në familje nuk është fenomen vetëm shqiptar. Shkaqet janë të ndryshme. Agresiviteti në shoqëri drejtohet nga më të dobëtit. Ngarkesa e problemeve jashtë familjes ndikon në atmosferën në familje. Varfëria është ombrellë për shumë nga këto probleme. Aktualisht, Universiteti i Tiranës ka pak ndikim në jetën sociale të vendit. Vetëm pak punime akademike botohen çdo vit. Ka nevojë për studimin e problemit të

dhunës në aspektin sociologjik, psikologjik dhe filozofik.

*Bashkim Gjergji, Gazetar dhe Përgjegjës i Departamentit të Gazetarisë  
në Universitetin e Tiranës.*

Dhuna në familje është një problem social që tërheq shumë vëmendjen e gazetarëve sot. Fakti që ky problem është prezent në shtypin tonë të përditshëm duhet konsideruar si një arritje e shtypit tonë të lirë. Jo shumë vite më parë, raportimi i dhunës në familje konsiderohej tabu. Rastet e dhunës në familje konsideroheshin si çështje private, ku askush nuk kishte të drejtë të ndërhynte. Aspekti negativ i disa artikujve mbi dhunën mbetet fakti që gazetarët kërkojnë të tërheqin vëmendjen e publikut duke i viktimizuar gratë e abuzuara dhe duke përforcuar stereotipet dhe paragjykimet ekzistuese.

*Rubena Moisiu, Pedagoge në Fakultetin e Mjekësisë dhe Mjeko Obsetre  
në Qendrën Spitalore Universitare.*

Mjekët e Qendrës Spitalore Universitare janë në kontakt të përditshëm me gratë e abuzuara. Ato vijnë për arsye mjekësore, të cilat shumë shpesh janë pasoja të drejtpërdrejta të dhunës që ato kanë përjetuar. Shumë prej tyre kanë plagë dhe shënja në trup, por ato shumë rrallë pranojnë të jenë abuzuar ose përdhunuar. Shumë mjekë, duke përfshirë këtu edhe vetën time, ndjehen të pafuqishëm për t'i ndihmuar gratë e abuzuara. Ne nuk mund t'ju ofrojmë atyre mbështetjen e duhur psikologjike, pasi ne nuk jemi të trajnuar për këtë. Referimi që ju bëhet për tek Qendra Këshilimore për Gra dhe Vajza varet nga njohuritë që kanë mjekët e veçantë për të. Ka një punonjës social në spital, por ajo merret kryesisht me foshnjat e abandonuara. Eksperiencat e trajnimeve multidisiplinore për fëmijët e abuzuar mund të realizohen edhe për gratë viktime të dhunës. Ndërsa fushata sensibilizuese janë organizuar në media, puna në komunitet për problemet e dhunës nuk është realizuar. Përfshirja e mjekut të familjes në projektet e komunitetit do të kontribuojë në ndryshimin e situatës.

## **D- Organizatat Ndërkombëtare :**

*Penny Martin, kordinatore për OJQ-të (OSBE)*

Të dhëna zyrtare e të besueshme për dhunën në familje nuk ekzistojnë në Shqipëri. OSBE dhe zyra e saj për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut ka bashkëpunuar me specialistin e trajnimeve për të Drejtat e Njeriut të UNOHCHR për të zhvilluar një kurs tremujor me policinë të quajtur: “Në ruajtje të të drejtave të grave: Dhuna në familje, prostitucioni, Trafikimi.” Ky kurs do të përfshihet në programet e trajnimit të policisë të organizuara nga MAPE dhe nga ICITAP (shih shpjegimet mbi

shkurtime në faqen e parë të këtij punimi). Kursi i trajnimit synon të sensibilizojë policinë për të drejtat e grave që janë abuzuar përmes dhunës në familje, prostitucionit të detyruar dhe trafikimit . Materialet e kursit do të përmbajnë informacione mbi OJQ-të që mund të mbështetin këto viktime, siç është Linja e Këshillimit dhe Strehëza. OSBE është duke organizuar një projekt edukimi për të Drejtat e Grave dhe Anti-Trafikimin, projekt që synon të organizojë trajnime për të drejtat e grave shqiptare mbështetur në konventat ndërkombëtare dhe ligjin shqiptar dhe për të shpjeguar se si shkelen këto të drejta kur gratë bëhen viktime të dhunës familjare apo të trafikimit. Këto trajnues do të organizojnë trajnime nëpër rrethe me grupe të veçanta si gazetarë, OJQ, punonjës civilë, gjyqtarë, të rinj dhe mësues.

*Valli Corbanese, kordinatore e projektit për programin e gruas shqiptare, financiar nga Qeveria Italiane, UNDP dhe UOPS.*

Për të studjuar problemin e dhunës në familje është e rëndësishme të kuptohet natyra e marrëdhënieve familjare midis bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijve dhe midis fëmijve. Në këtë fushë nuk ka shumë aktorë. Rrjeti aktual i OJQ-ve që punon në këtë fushë është i mbytur nga kërkesat dhe i mungojnë fondet. Mungojnë gjithashtu të dhënat e sakta për fenomenin . OJQ-të flasin për 70% të grave shqiptare si të abuzuara, por nuk ka asnjë studim kombëtar që ta vërtetojë këtë shifër. Aktualisht problemi i dhunës në familje po humbet teren si rezultat i mprehtësisë së problemit të trafikimit të qënieve njerëzore. Qeveria nuk ka një program në këtë fushë që të sigurojë bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm si policisë, punonjësve të shëndetësisë dhe punonjësve socialë. Duhet ngritur më shumë projekte punësimi për të përmirësuar dhe mbështetur pavarësinë ekonomike të grave.

## Pjesa III

### Paraqitja grafike e rrjeteve dhe iniciativave ekzistuese që luftojnë dhunën në familje në Shqipëri.

Nga studimi i materialeve dhe informacionit ekzistues mbi këtë problem, duket qartë se një numër i konsiderueshëm OJQ-sh janë përpjekur ta trajtojnë problemin dhe pastaj të merren me të në një masë sa më konkrete dhe realisht. Këto studime përbëjnë themelet e të kuptuarit të fenomenit, të kuptuar që do të influencojë vendimet përse i përket mënyrave efektive të luftës kundër tij. Pas dhjetë viteve tranzicioni, ka arritje dhe dështime në përpjekjet për eliminimin e dhunës në familje si nga ana e institucioneve shtetërore ashtu edhe të shoqërisë civile.

Avokatët e Minesotës për të Drejtat e Njeriut në raportin e tyre mbi Dhunën në Familje në Shqipëri në 1996, shprehen :

*Qeveria Shqiptare ka dështuar në përpjekjet për të plotësuar standartet ndërkombëtare.,.... burimet e dhunës në familje nuk dënohen mjaftueshëm dhe grave nuk ju ofrohet mbrojtja e duhur nga akte të mëtejshme dhune. .... Delegacioni nuk gjeti asnjë evidencë të ndonjë përpjekjeje që të siguron se njerëzit e ligjit dhe zyrtarë të tjerë përgjegjës për investigimin dhe ndëshkimin e dhunës ndaj gruas po trajtohen për të kuptuar faktorët unikalë dhe të komplikuar që përfshihen tek dhuna në familje<sup>27</sup>.*

Pas katër vjetësh, situata nuk duhet të ketë ndryshuar. Por, në të njëjtën kohë, organizatat e grave gjithnjë e më shumë po përfshihen në lëvizjen për propagandimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave, po organizojnë fushata sensibilizuese të opinionit publik mbi këtë problem, dhe po ofrojnë shërbime dhe mbështetje për gratë, vajzat dhe fëmijët e abuzuar. Më poshtë do të prezantojmë tre skema që tregojnë grupime të ndryshme të OJQ-ve. Skemat janë paraqitur në Konferencën Rajonale kundër dhunës gjinore dhe trafikimit që u mbajt në Tiranë nga 24 deri në 25 Qershor 2000. Ato u prezantuan nga S. Miria, drejtore e zhvillimit të Qendres së Këshillimit për Gra dhe Vajza.

Skema e parë prezanton Këshillin Kombëtar të Gruas Shqiptare që përbëhet nga 38 rrjete dhe koalicionet e OJQ-ve të grave në Shqipëri. Ato kanë qëllime dhe objektiva të ndryshme në punën e tyre, por qëllimi i tyre i përbashkët është fuqizimi i grave shqiptare në fusha të ndryshme të jetës.

Skema 1 – Këshilli Kombëtar i Gruas Shqiptare




Skema e dytë tregon Koalicinin Shqiptar kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit. Ky është një koalicion i krijuar në mënyrë natyrale. Ai përfaqëson një nivel të gjërë bashkëpunimi midis organizatave që kanë grumbulluar ekspertizë kanë qënë të suksesëshme në aktivitetin e tyre kundër dhunës dhe trafikimit. Bashkëpunimi i tyre konsiston në disa aktivitete të përbashkëta dhe iniciativa të rëndësishme për lëvizjen e gruas shqiptare kundër dhunës si dhe referimeve në shërbime të specializuara për klientë të përbashkët. Koalicioni përbëhet nga organizatat e mëposhtme :

- 1. Ne Dobi të Gruas Shqiptare*
- 2. Forumi i Pavarur i Gruas*
- 3. Planifikimi Familjar*
- 4. Qendra e Trajnimit Multidisiplinar në Ndihmë të Fëmijëve të Abuzuar*
- 5. Strehëza për Gratë e Trafikuara (projekte të IOM dhe ICMC)*
- 6. Shoqata e Grave Juriste*
- 7. Shoqata e Grave Refleksione*

Nga kjo skemë është e lehtë të kuptosh se rrethi nuk është i mbyllur. Vija e ndërprerë e rrethit presupozon mundësinë e përfshirjes së partnerëve të tjerë dhe zgjerimin e tij me organizata të tjera që janë të hapura për shkëmbime dhe bashkëpunime që mund të ndikojnë në politikën e shtetit.

**Skema 2 – Koalicioni Shqiptar kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit**




Skema e tretë prezanton Rrjetin e Dhunës Gjinore dhe Trafikimit që ofron shërbime për gratë dhe vajzat e dhunuara:

1. *Q.K.G.V.- Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza me qëndër në Tiranë dhe degët e saj në Shkodër dhe Pogradec. Ajo ofron mbështetje emocionale për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë ose janë të rrezikuara. Shërbimi ofrohet nëpërmjet linjës telefonike ose këshillimit ballë për ballë.*
2. *Q.A.G. – Qendra avokatore për Gratë është projekt i shoqatës së Grave Juriste. Ajo ofron këshillim juridik për gratë që kanë probleme juridike, si divorce, probleme pronësie apo kujdestari fëmijësh etj.*
3. *Strehëza – Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Abuzuara, është projekt i shoqatës Refleksione, që ofron strehim për gratë dhe vajzat në situatë krize. Ato mund të jenë viktima të dhunës familjare, janë të rrezikuara të abuzohen ose në situata të ngjashme. Nëpërmjet Strehëzës gratë marrin mbështetje emocionale dhe drejtohen në shërbime të tjera të specializuara si trajtimi mjekësor, këshillimi juridik, trajnime për punësim, strehim dhe lidhje me burime të tjera të mundëshme në komunitet.*
4. *Qendra e Gruas – Ofron ekspertizën e saj në parandalimin e dhunës kundër gruas. Ajo luan rol në koordinimin e aktivitetit të këtij rrjeti .*
5. *Shoqata Refleksione- Është e lidhur me ndërmarrje dhe biznese të ndryshme për të krijuar mundësi punësimi për gratë, veçanërisht për gratë e abuzuara. Kjo shoqatë është pioniere e shërbimeve afatgjata për gratë dhe ka gjeneruar nga viti në vit programe të ndryshme. Qendra e Këshillimit, Qendra e Gruas, Strehëza, Projekti për Fëmijët e abuzuar, kanë qënë të gjitha projekte të kësaj shoqate. Aktualisht, ato janë persona juridikisht të pavarur por bashkëpunojnë midis tyre për t’ju ofruar shërbime të specializuara për këtë kategori grash.*

Ky rrjet përfaqëson nivelin e parë të shërbimeve për klientet, ose e thënë ndryshe nivelin e shërbimeve direkte. Kjo infrastrukturë e rrjetit të shërbimeve kundër dhunës gjinore ka hedhur themelet për bashkëpunimin e organizatave të një niveli më të lartë, siç tregohet në skemën e dytë. Rrjeti kundër dhunës gjinore dhe koalicioni i OJQ-ve të ndryshme që u përmendën më sipër, mbështeten nga organizatat ndërkombëtare si vijon : SNV, ORT, Banka Botërore, NPA, NOVIB, UNDP, Qeveria Italiane, etj. Kontributi i këtyre donatorëve ka qënë jashtëzakonisht i rëndësishëm për aktivitetin e organizatave dhe institucioneve vendase.

Skema 3 – Rrjeti kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit



## Pjesa IV

### Rekomandime

#### Trajnime

Me ndihmën e MAPE dhe OJQ-ve të grave që kanë eksperiencë në këtë fushë, të përgatiten kurse trajnimi për studentët në Akademinë e Policisë dhe kurse rifreskimi për policët në shërbim.

Të përgatiten mjekët e ardhshëm për të ndihmuar gratë që janë viktimat të dhunës, duke përfshirë në programet e tyre mësimore kurse mbi teknikat e intervistimit. Sistemi i perkujdesit shëndetësor duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë fushë sëbashku me sektorët e tjerë si ai juridik, i policisë dhe shërbimet sociale. Punonjësit e shëndetësisë duhet të trajnohen për të dalluar si shënjat e dukshme të dhunës edhe ato më pak të dukshme dhe kë këtu këndvështrim për të plotësuar nevojat shëndetësore të grave. Nga këndvështrimi i shëndetit publik, është e rëndësishme të ngrihen programe si parandaluese ashtu edhe kuruese.

Të përgatiten trajnime mbi çështjet e dhunës në familje për gazetarët studentë dhe në profesion duke respektuar viktimën.

Të ngrihen kurse trajnimi me synim sensibilizimin e mjekëve dhe policëve dhe të hartohen protokolle të reja për trajtimin e viktimës së dhunës në familje.

Të ngrihen programe trajnimi profesional që të lehtësojnë punësimin e grave.

Të ngrihen programe për rritjen e nivelit të edukimit të grave me qëllim lehtësimin e punësimit të tyre .

Të ngrihen kurse për edukimin e prindërve se si të edukojnë fëmijët pa përdorur dhunë dhe për zgjidhjen e konflikteve.

Të planifikohen kurse në shkolla për edukimin gjinor dhe që parandalojnë dhunën gjinore.

Të trajnohen punonjësit socialë në komunitet se si të informojnë viktimën rreth detyrimit ligjor, mbështetjes së mundëshme financiare apo mbështetjeve të tjera të ofruara nga shteti, procedurave për ta siguruar këtë mbështetje. Ata duhet të trajnohen për të identifikuar dhunën dhe viktimat që kanë nevojë për trajtim.

## *Qeveria*

Të hartojë politika që nxisin bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm në këtë fushë, siç janë forcat e policisë, punonjësit e shëndetësisë dhe punonjësit socialë.

Të hartojë politika që inkurajojnë bashkëpunimin midis punonjësve socialë, mjekëve dhe policisë.

Të hartojë politika që rriten përgjigjen e kapaciteteve institucionale ndaj dhunës në familje.

Të ofrojë mbështetje financiare për shërbimet direkte sociale.

Të hartojë strategji me donatorë të tjerë për të ngritur dhe mbështetur shërbime në të gjithë vendin.

Të koordinojë aktivitetet e drejtuara nga Komiteti Gruaja dhe Familja, midis Qeverisë dhe OJQ-ve aktive në fushën e dhunës në familje.

Të harmonizojë politikat ekonomike, sociale dhe institucionale.

## *Policia*

Të përgatiten, me ndihmën e punonjësve socialë, materiale informative që t'ju shpërndahen forcave të policisë.

Të inkurajohet shkëmbimi i informacionit midis forcave të policisë dhe OJQ-ve të grave.

Të publikohen artikuj mbi dhunën në familje në gazetën shqiptare "Policia Sot".

Të rekrutohen oficerë policie gra dhe të përgatiten në mënyrë të veçantë për t'u marrë me viktimat e dhunës në familje.

## *Studimet*

Të realizohet një anketim mbarëkombëtar duke respektuar një metodologji të qartë (modeli dhe teknikat e intervistimit si dhe formulimin e pyetjeve). Të inkurajohet kërkimi shkencor që e shikon problemin e dhunës në familje nga këndvështrimi sociologjik, psikologjik dhe filozofik. Gjithashtu ka nevojë të identifikohet profili i dhunuesit.

Të zhvillohet një strategji kërkimi me Fakultetin e Shkencave Sociale nëpërmjet të cilës të inkurajohen pedagogët dhe studentët të bëjnë studime mbi problemin e dhunës në familje.

## *Fushata e ndërgjegjësimit*

Të përgatiten programe televizive mbi dhunën në familje.

Të angazhohen pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale (Universiteti i Tiranës) për të luajtur një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e publikut nëpërmjet medias.

Të punohet me mjekët e familjes në komunitet.

Të zhvillohen aktivitete me nxënësit e shkollave të mesme e tetëvjeçare për të sensibilizuar ata për shkaqet dhe pasojat e dhunës.

Të organizohen diskutime publike.

Të organizohen anketime publike për temat e dhunshme në radio dhe televizion.

## *Projekte për komunitetin*

Të ngrihet një qendër multidisiplinore për gratë dhe fëmijët e abuzuar ku mbi bazën e metodave integruese të bëhet vlerësimi i situatës dhe ofrimi i shërbimit.

Të ngrihen Linja dhe Srehëza të tjera në rrethe të tjerë të vendit.

Të ngrihen grupe mbështetëse për gratë e dhunuara ku ato të kenë mundësi të ndajnë eksperiencën e tyre.

Të ngrihen grupe me burrat ku ata të inkurajohen të shprehin opinionet e tyre dhe të nxitet ndryshimi i mentalitetit të tyre për këtë çështje.

Të ngrihen në komunitete rrjete të koordinuar dhe të integruara ku sistemi shëndetësor, ai juridik, policia, kishat, punonjësit socialë dhe grupet e komunitetit të mblidhen rregullisht për të hartuar dhe zbatuar një reagim të koordinuar ndaj dhunës në familje.

## *Konkluzione*

Ndjehet e nevojshme të atakohet dhuna në familje në Shqipëri. Duhet ndërtuar një marrëdhënie më e mirë bashkëpunimi midis Qeverisë dhe shoqërisë civile për të luftuar dhunën ndaj gruas. Me qëllim që të zvogëlohet numri i rasteve të dhunës në familje në Shqipëri, është e nevojshme të krijohet një vizion i përbashkët që do të na çonte në

veprime të përbashkëta. Për ta parandaluar dhunën, por edhe për të ndihmuar viktimat, është e nevojshme që juristët, psikologët, mjekët, policët dhe punonjësit socialë të punojnë së bashku.

## *Bibliografi*

Fullani, A., *Të Drejtat Ligjore të Grave*, Tirana 1999.

Gjipali, S. & Ruci, L., *Gruaja Shqiptare: Hezitime dhe perspektiva*, Rrjeti European i studimeve për gratë, Bukuresht, 1994.

Haxhiymeri, E. & Kulluri, E., *Studime mbi rastet e Strehëzës*, Tirana 2000.

Haxhiymeri, E., *Dhuna në familje në Shqipëri*, Disertacion, 1996.

Kaçi, B., *Dhuna kundër grave - Një problem kombëtar*, Tiranë 1996.

*Kanun i Lekë Dukagjinit, botim në gjuhën shqipe - përgatitur nga Shtjefën Gjeçovi.*

Meçaj, V., *Mbrojtja e të drejtave të grave në Shqipëri-Analizë e situatës aktuale*, Tirane, 1997.

Minnesota Advocates for Human Rights, *Domestic Violence in Albania*, prill 1996.

Miria, S., *Dhuna ndaj grave dhe tabutë psikosociale që e favorizojnë atë*, Botim i shoqatës Refleksione, Tirane 1996.

Sala, V. & Miria, S. *Studime mbi studimet*, 1999.

Shoqata “Në dobi të gruas shqiptare”, *Prostitucioni-shoqëria në dilemë*, Tirana 1997.

UNICEF Innocenti Research Centre, *Domestic Violence Against Women*, Innocenti Digest, 2000.

- <sup>1</sup> UNICEF Innocenti Research Centre, Domestic Violence Against Women, Innocenti Digest, 2000
- <sup>2</sup> Haxhiymeri, E., Dhuna në Familje në Shqipëri, temë dizertacioni, 1996, f.42
- <sup>3</sup> Shoqata “Në dobi të gruas shqiptare”, *Prostitucioni-shoqëria në dilemë*, Tirana 1997, f.24.
- <sup>4</sup> Sala, V. & Miria, S. Studim mbi studimet, 1999, f.54.
- <sup>5</sup> *Kanun i Lek Dukagjinit*, paragrafi XXVIII dhe XXXI, botim në shqip i përgatitur nga Shtjefen Gjecov.
- <sup>6</sup> *Kanun i Lek Dukagjinti*, paragrafi XXXI, botimi në shqip i përgatitur nga Shtjefen Gjecov.
- <sup>7</sup> *Kanun i Lek Dukagjinit*, paragrafi XXVIII, botimi në shqip i përgatitur nga Shtjefen Gjecov.
- <sup>8</sup> *Kanun i Lek Dukagjinit*, paragrafi XXXI, botimi në shqip i përgatitur nga Shtjefen Gjecov.
- <sup>9</sup> Sala, V. & Miria, S. Studim mbi studimet, 1999, f.55.
- <sup>10</sup> Gjipali, S. & Ruci, L., *The Albanian woman: Hesitation and perspectives*, European Network for Women’s Studies, Bucharest, 1994, p.35.
- <sup>11</sup> Miria, S., *Dhuna ndaj grave dhe tabutë psikosociale që e favorizojnë atë*, Botim i shoqatës Refleksione, Tirane 1996, p.3.
- <sup>12</sup> Miria, S., *Dhuna ndaj grave dhe tabutë psikosociale që e favorizojnë atë*, Botim i shoqatës Refleksione, Tirane 1996.
- <sup>14</sup> Miria, S., *Dhuna ndaj grave dhe tabutë psikosociale që e favorizojnë atë*, Botim i shoqatës Refleksione, Tiranë 1996, p.11.
- <sup>15</sup> Kaci, B., *Dhuna kundër grave - Një problem kombëtar*, Tiranë 1996, p.58.
- <sup>16</sup> Kaci, B., *Dhuna kundër grave - Një problem kombëtar*, Tiranë 1996, p.58.
- <sup>17</sup> Haxhiymeri, E. & Kulluri, E., Studim mbi rastet e trajtuara në strehez, Tirana 2000.
- <sup>18</sup> General Assembly Resolution 48/104, 1993.
- <sup>19</sup> Minnesota Advocates for Human Rights, *Domestic Violence in Albania*, April 1996, f.14.
- <sup>20</sup> Miria, S., *Dhuna ndaj grave dhe tabutë psikosociale që e favorizojnë atë*, Botim i shoqatës Refleksione, Tirane 1996, f.6.
- <sup>21</sup> Sala, V. & Miria, S. Studim mbi studimet, 1999, f.59-62.
- <sup>22</sup> Fullani, A., *Të Drejtat Ligjore të Grave*, Tirana, 1999, f.7.
- <sup>23</sup> Mecaj, V., *Mbrojtja e të drejtave të grave në Shqipëri-Analizë e situatës aktuale*, Tiranë, 1997, f.8.
- <sup>24</sup> Fullani, A., *Të Drejtat Ligjore të Grave*, Tirana 1999, f.10.
- <sup>25</sup> Miria, S., *Dhuna ndaj grave dhe tabutë psikosociale që e favorizojnë atë*, Botim i shoqatës Refleksione, Tiranë 1996, f.4.
- <sup>26</sup> Fullani, A., *Të Drejtat Ligjore të Grave*, Tirana, 1999, f. 8
- <sup>27</sup> Minnesota Advocates for Human Rights, *Domestic Violence in Albania*, prill 1996, p.23.